

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Shoqëria për Tregti dhe Shërbime PROMET STEEL HOLDING SHPK Shkup, me seli në rr. „Enver Idrizi“ nr. 16a, Shkup – Saraj, Republika e Maqedonisë së Veriut, përmes avokatit Samoil Filipovski nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 20.05.2026, miratoi këtë

AKTVENDIM

1. Konstatohet se përqendrimi me të cilin Shoqëria për Tregti dhe Shërbime PROMET STEEL HOLDING SHPK Shkup, me seli në rr. „Enver Idrizi“ nr. 16a, Shkup – Saraj, Republika e Maqedonisë së Veriut, do të fitojë kontroll mbi Shoqërinë për Shërbime MGF INVESTMENT SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rr. „Nikola Kljusev“ nr. 6, kati 7, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, përmes shitblerjes së pjesës, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë të tij thelbësore, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në shumën prej 6.000,00 denarë dhe për vendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3. Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e pezullon ekzekutimin e këtij aktvendimi.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 29.04.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftim për përqendrim nga Shoqëria për Tregti dhe Shërbime PROMET STEEL HOLDING SHPK Shkup, me seli në rr. „Enver Idrizi“ nr. 16a, Shkup – Saraj, Republika e Maqedonisë së Veriut, me të cilin PROMET STEEL HOLDING SHPK Shkup do të fitojë kontroll të vetëm mbi Shoqërinë për Shërbime MGF INVESTMENT SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rr. „Nikola Kljusev“ nr. 6, kati 7, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, nëpërmjet shitblerjes së pjesës.

Komisioni filloi shqyrtimin e njoftimit në ditën e pranimi të tij dhe, në bazë të të dhënave të paraqitura në njoftimin për përqendrim dhe dokumentacionit bashkëlidhës, konstatoi si vijon:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

Veprimtaria prioritare e PROMET STEEL HOLDING SHPK Shkup është tregtia me shumicë e drurit, materialeve ndërtimore dhe pajisjeve sanitare. PROMET STEEL HOLDING SHPK Shkup është një shoqëri holding, e cila ka 3 degë në sektorë të ndryshëm (nxjerrja e gurit dekorativ dhe gurit për ndërtimtari, gurit gëlqeror, gipsit të papërpunuar, shkumësit dhe argjilorëve, tregtia me shumicë e drurit, materialeve ndërtimore dhe pajisjeve sanitare, si dhe veprimtaritë menaxhuese

PROMET STEEL HOLDING SHPK Shkup, si shoqëri holding dhe si shoqëri mëmë, ka dy shoqëri të lidhura, si vijon:

1. Shoqëria për Transport, Tregti dhe Shërbime STEEL TRANS SHPKNJP import-eksport Shkup, me seli në rr. „Enver Idrizi“ nr. 16a, Shkup – Saraj, me veprimtari të regjistruar 49.410 – transport rrugor i mallrave; dhe
2. Shoqëria për Prodhim, Tregti dhe Shërbime STIL KONTROL SHPKNJP Shkup, me seli në rr. „Hasan Prishtina“ nr. 145, Vizbegovë, Butel, Shkup, me veprimtari të regjistruar 43.990 – punë të tjera të specializuara ndërtimore, të pa përfshira në vend tjetër.

MGF INVESTMENT SHPKNJP Shkup është themeluar në vitin 2025, me veprimtari të regjistruar veprimtari të tjera shërbyese. Megjithatë, MGF INVESTMENT SHPKNJP Shkup ende nuk ka realizuar veprimtari afariste.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafët (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat, gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i paraqitur, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin, pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE**

Mr. Малинка Силјановска Николиќ